



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 shtator 2015
Nr. ref.: RK 844/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI185/14

Parashtrues

Zoran Kolić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PML 125/14, të 8 korrikut 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Zoran Kolić nga Lipjani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga z. Miodrag Brkljać, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML 125/14, të 8 korrikut 2014, me të cilin ish-in refuzuar kërkesat e tij për mbrojtje të ligjshmërisë. Aktgjykimi i ishte dorëzuar parashtruesit më 20 gusht 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] (1) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe Konventës kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.
4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata *“që në kuptim të nenit 39 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të mbajë një seancë dëgjimore publike, pasi që besoj se mbajtja e saj është e nevojshme për t'i qartësuar provat”*.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe me rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 dhjetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 13 janar 2015, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 30 janar 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI185/14, e caktoi zëvendëskryetarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, të cilit mandati në Gjykatën Kushtetuese i përfundoi më 26 qershor 2015.
10. Më 8 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 11 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale dhe e dënoi atë me dënim me burgim dhe me gjobë.
12. Më 25 shtator 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR 1121/12) aprovoi pjesërisht ankesat e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, duke i bashkuar dy vepra penale në një.
13. Pas kësaj, më 8 maj 2014, avokatët e tij mbrojtës parashtruan kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu parashtri një kërkesë të tij.
14. Të dy avokatët mbrojtës dhe parashtruesi i kërkesës pretenduan se *“një sërë arsyesh janë paraqitur nga avokatët mbrojtës dhe i akuzuari (...), dhe të cilat kanë të bëjnë vetëm me vlerësimin faktik të rastit”*.
15. Në të vërtetë, mbrojtja bazoi ankesën në atë se *“provat nuk kualifikohen si krime lufte; nuk kishte asnjë provë për bashkëkryerje: Aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme dhe gjykata e shkallës së parë ka tejkaluar aktakuzën”*.
16. Më 24 qershor 2014, Prokurori i Shtetit konstatoi se parashtruesat e mbrojtjes nuk ishin të bazuara dhe se kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë duhet të refuzohen.
17. Më 8 korrik 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi PML 125/2014) refuzoi kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës dhe të mbrojtësve të tij dhe vërtetoi aktgjykimet e gjykatave më të ulëta.
18. Gjykata Supreme u kujtoi avokatëve mbrojtës dhe të akuzuarit se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 432 të KPPK-së, nuk është e lejueshme *“kur bazohet në ‘vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike’ dhe se “nuk duhet të përdoret si një metodë indirekte për ankesë të mëtejshme”*.
19. Gjykata Supreme konsideron se *“çdo parashtrës nga avokatët mbrojtës apo nga i akuzuari, lidhur vetëm me vërtetimin e gjendjes faktike nuk do të shqyrtohet”*. Përveç kësaj, Gjykata Supreme *“nuk ka gjetur asnjë shkelje të ligjit penal apo të drejtës procedurale”* në lidhje me arsyet e tjera të paraqitura nga mbrojtja.
20. Në fund, Gjykata Supreme arriti në përfundimin se *“Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i arsyetuar mirë, i hollësishëm dhe ujen deri te një rezultat i drejtë”*; se nuk kishte *“arsye për përsëritje të gjetjeve të Gjykatës së Apelit”* dhe *“plotësisht pajtohet me vlerësimin e nxjerrë nga kolegji i ankesave”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuara janë shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 6 [E drejta për proces të rregullt] të KEDNJ-së dhe me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë *“për shkak të mënyrës se si janë kryer këto gjykime”*.
23. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Prova tërësisht të pabesueshme, të pasigurta dhe kontradiktore që nuk kanë asnjë rëndësi apo peshë, u vlerësuan si të mjaftueshme për të marrë vendimin për fajësinë e një njeriu krejtësisht të pafajshëm”*.
24. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se parimi i prezumimit të pafajësisë është shkelur në mënyrë drastike dhe se Gjykata Kushtetuese duhet ta konfirmojë këtë parim.
25. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ankohet se, gjatë paraburgimit të tij, ai ishte shënjuar në mënyrë të tillë që të gjithë e dinin se ai ishte një kriminel luftime. Si pasojë, ai kishte vuajtur trauma të rënda psikologjike që e pengonin atë të përqendrohej në mbrojtjen e tij për gjykimet e ardhshme. Ai konsideron se veprimi i përshkruar është në kundërshtim me Konventën kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.
26. Parashtruesi i kërkesës, në fund, kërkon nga Gjykata *“që të dëshmohet se të dënuarit i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë si dhe të drejtat tjera të njeriut, të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”*.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
28. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
29. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkoi që të mbrojtje të drejtat e tij në Gjykatën e Qarkut dhe Gjykatën e Apelit dhe se ai parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmerisë në Gjykatën Supreme. Prandaj, ai duhet të

konsiderohet se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të Kosovës.

30. Përveç kësaj, neni 49 [Afatet] i Ligjit, parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

31. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se dita e fundit e periudhës katërmuajshe për parashtruesin bie të shtunën, më 20 dhjetor. Megjithatë, rregulli 27 (f) i Rregullores së punës parasheh që *“nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj”*. Prandaj, parashtruesi i kërkesës ka mundur ta dorëzojë kërkesën në mënyrën e duhur të hënën, më 22 dhjetor.

32. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi dhe se ai parashtrroi në kohë kërkesën në Gjykatë.

33. Megjithatë, Gjykata gjithashtu duhet të marrë parasysh nenin 48 [Saktësia e kërkesës] të Ligjit dhe rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës.

34. Neni 48 i Ligjit parasheh si në vijim:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

35. Rregulli 36 i Rregullores së punës parasheh si në vijim:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

36. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P 408/11, të 11 majit 2012, dhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR 1121/12, të 25 shtatorit 2013, është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

37. Parashtruesi i kërkesës thekson që Gjykata e Qarkut dhe Gjykata e Apelit kishin vlerësuar gabimisht se provat krejtësisht të pasigurta dhe jo të besueshme ishin të mjaftueshme për ta shpallur fajtor atë.

38. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta apo nga autoritetet e tjera publike, përveç dhe për

aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

39. Prandaj, Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritetet e tjera publike, pasi që është roli i tyre, kur kjo është e mundshme, të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
40. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi dhe të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, 10 korrik 1991).
41. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ishte ndihmuar nga avokatët e tij mbrojtës në procedurë dhe se gjykatat me kujdes i kanë shikuar të gjitha provat dhe tërësisht i kanë arsyetuar vendimet e tyre.
42. Për më tepër, Gjykata Supreme konsideroi se nuk mund t'i marrë parasysh kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë në lidhje me situatën faktike dhe se nuk ka mundur të gjejë shkelje të së drejtës penale apo procedurale në lidhje me arsyet e tjera të paraqitura nga mbrojtja.
43. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konkludoi se vendimi i Gjykatës së Apelit ishte i arsyetuar mirë, i detajuar dhe solli një rezultat të drejtë dhe se plotësisht u pajtua me arsyetimin e dhënë nga ajo gjykatë.
44. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese konsideron se procedurat në Gjykatën e Qarkut, në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme kanë qenë të drejta dhe të kryera mirë (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituaniës*, Nr. 17064/06, KEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009) dhe se parashtruesi i kërkesës nuk kishte saktësuar se si ishin shkelur nenet e Kushtetutës, të cilave ai u referohet, siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.
45. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës, për shkak se, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 432 të KPPK-së, një kërkesë e tillë nuk është e lejueshme “kur bazohet në konstatimin e gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike”.
46. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar me saktësi se si dhe pse një vendim i tillë i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të cilat ai pretendon se i janë shkelur.
47. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka ndërtuar dhe nuk ka dëshmuar një rast në lidhje me “ndonjë shkelje të së drejtës penale apo procedurale” të dorëzuar nga ai apo nga mbrojtësit e tij në Gjykatën Supreme.

48. Për më tepër, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se ai ishte shënjuar si një kriminel lufte gjatë paraburgimit të tij, që e pengonte atë të përqendrohej në përgatitjen e mbrojtjes së tij.
49. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se ai e ka ngritur atë pretendim para gjykatave të rregullta ose se këto rrethana e kanë penguar atë për të përgatitur mbrojtjen e tij në procedurën penale.
50. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk e ka dëshmuar pretendimin për keqtrajtim, të cilin e kishte vuajtur derisa ishte në paraburgim dhe nuk ka paraqitur asnjë provë që mund ta dëshmojë pretendimin e tij.
51. Si përmbledhje, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij sipas Kushtetutës dhe KEDNJ-së janë të paargumentuara dhe të padëshmuara dhe, prandaj, janë qartazi të pabazuara.
52. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi që, në pajtim me rregullin 39 [E Drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës, Gjykata duhet të mbajë një dëgjim publik për të sqaruar provat.
53. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit të kërkesës për të mbajtur një dëgjim publik nuk përmbush asnjë nga kushtet e parapara me rregullin 39 [E Drejta në dëgjim dhe heqja dorë] të Rregullores së punës.
54. Për më tepër, mbajtja e një dëgjimi publik për të sqaruar provat e çështjes do të binte nën juridiksionin e një "gjykate të shkallës së katërt". Siç u tha më lart, Gjykata Kushtetuese nuk është një "gjykatë e shkallës së katërt".
55. Në fund, Gjykata tashmë konkludoi se kërkesa është e papranueshme, si qartazi e pabazuar. Në këtë mënyrë, Gjykata merr parasysh se rregulli 39 i Rregullores së punës parashih që "*Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës*". Prandaj, kërkesa e parashtruesit për mbajtjen e seancës dëgjimore refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 29 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) dhe 56 të Rregullores së punës, më 8 korrik 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi